

PAKR.nr.582/18

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Tonka Berishaj, kryetare, Xhevdet Abazi dhe Hashim Çollaku, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Përparim Zeka, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve I.D. nga Ferizaji, për shkak të veprave penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KPRK-së, dhe të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, dhe të akuzuarit I.I., gjithashtu nga Ferizaji, për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 2 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesat e mbrojtësve të akuzuarve I.D., av. A.I. dhe të akuzuarit I.I. av. A.D., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore- Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr.181/2018 të datës 16.10.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK, më datë 28.12.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të akuzuarve I.D. dhe I.I., ndërsa, aktgjykimi i Gjykatës Themelore- Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr.181/2018 të datës 16.10.2018, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr.181/2018 të datës 16.10.2018, të akuzuarit I.D. dhe I.I. janë shpallur fajtorë dhe atë: i akuzuari I.D., për shkak të veprave penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, ndërsa, i akuzuari I.I., për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 2 të KPRK-së, dhe për këto vepra penale

janë gjykuar dhe atë: i akuzuari I.D., për veprën e parë penale me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, dhe dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) €, ndërsa, për veprën e dytë penale me dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) €, për çka, pastaj, gjykata me aplikimin e dispozitave për shqiptimin e dënimit për veprat penale në bashkim i ka shqiptuar dënim unik me gjobë në shumë prej 1.100 €, dënim ky në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 07.08.2018 e tutje, ndërsa, të akuzuarin I.I. për veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 2 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vjet, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 16.10.2018, e tutje, i cili do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, ndërsa, për të akuzuarin I.D., ka konstatuar se nëse dënimi me gjobë nuk e paguan i akuzuari, atëherë i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do t'i llogaritet në shumë prej 20 €.

Të akuzuarve, gjykata iu ka shqiptuar edhe dënimi plotësues, ashtu që të njëjtit i ka konfiskuar substancën narkotike të llojit "Marihuanë" në peshë prej 1.331 gr. dhe substancën narkotike të llojit "kokainë" me sasi prej 4,05 gram, dy peshore digjitale për matjen e sasisë së narkotikut, një pistoletë "Zoraki M906-B" nr.0004460118, një karikator dhe gjashtë fishekë të kalibrit 7.65 m.m, si mjete me të cilat është kryer vepra penale.

Të akuzuarit i ka obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 30 €, si dhe shumë prej nga 50 € në emër të Fondit për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesa kanë paraqitur:

Mbrojtësi i të akuzuarit I.D., av. A.I., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i butë me burgim dhe me gjobë, se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Mbrojtësi i të akuzuarit I.I., av. A.D., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i butë me burgim dhe me gjobë, se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK-së, për të cilën i ka njoftuar Prokurorinë e Apelit, të akuzuarit I.D. dhe I.I. dhe mbrojtësin e tyre av. A.I. dhe av. A.D.. Në seancën e kolegjit prezantuan mbrojtësit e të akuzuarve av. A.I. dhe av. A.D., si dhe të akuzuarit, ndërsa edhe pse të ftuar në mënyrë të rregullt nuk prezantoi askush nga Prokuroria e Apelit, për çka, gjykata seancën e kolegjit e mbajti pa prezencën e prokurorisë konform dispozitave të nenit 390 par. 4 të KPPK-së. Në seancën e kolegjit mbrojtësit e të akuzuarve av. A.I. dhe A.D., pasi më parë sqaruan disa nga pretendimet ankimore mbeti në tërësi pranë propozimeve në ankesë, duke shtuar për të akuzuarin I.D. se i njëjti tani është martuar dhe ka krijuar bashkësi martesore, prandaj, kërkon që të merret parasysh edhe kjo rrethanë, të cilët i përkrahën edhe të akuzuarit I.D. dhe I.I..

Prokuroria i Apelit, përmes parashtrësës me shkrim PPA/I.nr.552/18, të datës 12.12.2018, i propozoi gjykatës që ankesat e mbrojtësve të akuzuarve të refuzohen si të pa bazuara, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi që i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes së bashku me aktgjykimin e ankimuar, të cilat i vlerësoi konform dispozitës së nenit 394 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve të theksuara në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk janë të bazuara.

Me ankesat e mbrojtësve të akuzuarve I.D., dhe I.I. av. A.I. dhe av. A.D., aktgjykimi i shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit, të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPPK, dhe konstatoi se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarve, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu, as gjendja e fakteve nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase as me ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse të akuzuarit në seancën e shqyrtimit fillestar e kanë pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës dhe trupi gjykues është pajtuar me një pohim të tillë – neni 383 par. 2 të KPPK, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore.

Duke e shqyrtuar çështjen përkritazi me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve përkritazi me këtë bazë ankimore nuk qëndrojnë.

Me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, I.D., av. A.I., potencohet se gjykata e shkallës së parë, i ka konstatuar shumicën e rrethanave lehtësuese, mirëpo të njëjtat nuk janë vlerësuar realisht e as në masë të duhur, për çka sidomos është dashur të merret parasysh rrethanat, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, ka bashkëpunuar me policin gjatë gjithë fazës hetimore në këtë çështje penale-juridike duke ndihmuar kështu me ndriçimin e kësaj çështje penale – juridike, pastaj ka shprehur keqardhje duke u penduar thellë për kryerjen e veprës penale, pastaj, sidomos nuk është marrë parasysh gjendja e tij shëndetësore, ku i akuzuari vuan nga sëmundja kronike e zemrës, për çka edhe gjatë kohës sa ka qëndruar në paraburgim është shtrirë në Spitalin e QKUK-së, - Klinikën Kardiologjike, prandaj, bazuar në rrethanat e cekura më lartë, e duke marrë parasysh dispozitat e nenit 75 par. 1 nën par. 3 të KPK-së, ka mundësi që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i butë – pra, nën minimumin e paraparë ligjor. Ndërsa, mbrojtësi i të akuzuarit I.I., av. A.A., pretendon se gjykata e shkallës së parë, i ka shqiptuar të akuzuarit dënim të rëndë me burgim, ngase, duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese të konstatuara e sidomos pranimin e fajësisë, pastaj, faktin se të akuzuarit i është gjetur një sasi e vogël e substancës narkotike, se i njëjti pastaj është edhe përdorues i substancës narkotike, se ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejë veprë penale, atëherë me zbatimin e dispozitave për zbutje të dënimit është dashur që të akuzuarit, t'i shqiptohet një dënim shumë më i butë se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit kundër të akuzuarve në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse ka vlerësuar të gjitha rrethanat ashtu sikur që parashihen me dispozitat e nenit 73 të KPK-së, ku si rrethana lehtësuese të akuzuarve iu ka marrë se të njëjtit kanë pranuar fajësinë dhe njëkohësisht janë penduar, kanë premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra tjera penale, kanë pasur sjellje të mirë në gjykatë, kurse si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë pranimin e fajësisë, ndërsa, si rrethana rënduese ka marrë faktin se të akuzuarit janë të gjykuar me aktgjykimi të formës së prerë edhe njëri edhe tjetri dhe atë për vepra të ngjashme penale, pra, nga neni 273 par. 1 të KPK-së, prandaj, duke pasur parasysh rrethanat që u cekën më lartë, e sidomos faktin se të akuzuarit janë shpallur fajtor dhe janë gjykuar me aktgjykim të formës së prerë edhe për vepra tjera të ngjashme penale, atëherë, mënyrën e vlerësimit të rrethanave nga gjykata e shkallës së parë, në tersi e aprovon edhe kjo gjykatë e sidomos kur të akuzuarit i ka shqiptuar dënim në minimumin e paraparë ligjor. Prandaj pretendimet e theksuara në ankesë nga mbrojtësit edhe pse cekën disa rrethana lehtësuese që gjykata e shkallës së parë, nuk i ka marrë parasysh, të njëjtat nuk janë të asaj natyre që do të ndikonin në zvogëlimin e mëtuqjeshëm të dënimit, gjegjësisht nën minimumin e paraparë ligjor, kur merret parasysh sidomos fakti se të akuzuarit janë të dënuar edhe disa hera të tjera, atëherë konsiderojmë se dënimi i shqiptuar të akuzuarve nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm ngase, është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve, intensitetin e rrezikshmërisë së veprës penale, e po ashtu është në funksion të preventivës gjenerale dhe individuale. Prandaj, duke pasur parasysh rrethanat e cekura më lartë, rrethanat e rastit konkret, rezulton se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.582/2018, më dt. 28.12.2018

Procesmbajtës,
Përparim Zeka

Anëtarët e kolegjit,
1. _____
Xhevdet Abazi
2. _____
Hashim Çollaku

Kryetare e kolegjit,
Tonka Berishaj